



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA SOLEMNE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, ME
RASTIN E VIZITËS NË KOSOVË TË KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË SALI BERISHA, E MBAJTUR MË 6 TETOR 2009

SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA POVODOM POSETE
KOSOVU PREMIJERA REPUBLIKE ALBANIJE SALI BERIŠE, ODRŽANE 6
OKTOMBRA 2009. GODINE

TETOR – OKTOMBAR
2009

E martë, më 6 tetor 2009

Seancën drejtoi: z. Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: JAKUP KRASNIQI

Të nderuar deputetë,
I nderuar President i Republikës së Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu,
I nderuar Kryeministër, zoti Hashim Thaçi,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar ambasadorë dhe diplomatë,
Zonja dhe zotërinj,
Mirë se keni ardhur në seancën e sotme solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
të thirrur për nder të vizitës së Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, zotit Sali Berisha.

(Duartrokitje)

Kuvendi i Kosovës ka nderin ta ketë sot mysafir Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, zotin Sali Berisha, të cilin e përshëndes në emrin tuaj dhe timin, duke i uruar mirëseardhje në Republikën e Kosovës dhe në këtë seancë solemne parlamentare.

Zoti Kryeministër i Shqipërisë, ju faleminderit shumë për praninë tuaj në këtë sallë dhe për fjalën me të cilën do t'i drejtoheni Kuvendit tonë. Vizita Juaj përbën eveniment për Kosovën, por edhe rast të mirë për t'u informuar drejtpërdrejt me ndryshimet e mëdha pozitive që vendi ynë ka bërë gjatë kësaj kohe të shkurtër pas shpalljes së pavarësisë.

Pavarësia e Kosovës, tashmë e njohur nga 62 vende anëtare të OKB-së, po mbështetet gjerësisht nga bashkësia ndërkombëtare. Ne presim njohje të reja dhe hyrjen e Kosovës në familjen e madhe të Kombeve të Bashkuara. Në partneritet ndërkombëtar, ne po ndërtojmë shtetin e ri me një rend kushtetues të demokracisë moderne, me një shoqëri të lirë e sovrane dhe në barazi të plotë për të gjithë qytetarët, pa asnjë dallim. Kosova është kthyer në një faktor paqeje e stabiliteti në rajon.

Zoti Kryeministër,

Pavarësia e Kosovës ishte kurorëzim i përpjekjeve të gjata dhe të dhembshme të popullit të saj, por edhe i një solidariteti të gjerë ndërkombëtar me të drejtën e tij legjitime për të qenë i lirë dhe sovran i fatit të vet.

Shqipëria ka qenë mbështetëse e Kosovës në luftën e saj të gjatë për liri dhe pavarësi, kurse në momente të caktuara historike, veçanërisht të rënda, ajo kishte rolin përcaktues

të ruajtjes së identitetit, por edhe të ekzistencës fizike të shqiptarëve jashtë kufijve të saj.

Unë dua ta shfrytëzoj edhe këtë rast që më jepet për t'ju shprehur Juve dhe gjithë Shqipërisë mirënjohjen e thellë, në emër të Kuvendit të Kosovës, të qytetarëve dhe timin personalisht për gjithë çfarë keni bërë për Kosovën dhe për qytetarët e saj.

Epoka në të cilën kemi hyrë, u ka hapur rrugë dhe perspektivë të shkëlqyer marrëdhënieve midis Shqipërisë e Kosovës, si dhe integriteteve rajonale e euroatlantike të tyre. Rruga e re dhe moderne, që lidh Shqipërinë dhe Kosovën, për të cilën Ju zoti Kryeministër keni meritë të veçantë, përbën jo vetëm një kusht shumë të rëndësishëm të lëvizjes së lirë të mallrave e të qytetarëve dhe të zhvillimit ekonomik të të dy vendeve tona, por edhe një arterie të ardhshme ndërkombëtare që do t'u kontribuojë marrëdhënieve rajonale.

Zoti kryeministër Berisha, duke ju falënderuar edhe njëherë, kam kënaqësinë t'ju ftoj t'i drejtoheni me një fjalë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

(Duartrokitje)

KRYEMINISTRI I SHQIPËRISË: SALI BERISHA

I nderuar zoti President i Republikës së Kosovës,
I nderuar zoti Kryeministër,
I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputete dhe deputetë,
Shkëlqesi - ambasadorë dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare,
Të dashur qytetare dhe qytetarë të Kosovës,

Së pari dëshiroj t'ju falënderoj për zemërsisht dhe me mirënjohje të thellë ju të nderuar deputetë dhe ju zoti Kryetar Jakup Krasniqi, për nderin e madh që më bëtë duke më dhënë fjalën në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Unë e përjetoj këtë moment, si një nga ngjarjet më të shënuara të jetës sime. Kjo sepse, ju - burrat dhe gratë, të rinjtë dhe të rejtat e Kosovës, me sakrificat dhe përpjekjet tuaja mbinjerëzore shndërruat në realitet ëndrrën më të lashtë, më fisnike, më të bukur, më sublime të njeriut të qytetëruar, ëndrrën e lirisë, kurse ai dhe ata që dikur me zinxhirët e tankeve u vërsulën mbi parlamentin tuaj, përfunduan në galerat e historisë, ku e meritonin.

Kosova, në 130 vitet e fundit, ka qenë gjithnjë djepi i lëvizjeve të mëdha kombëtare emancipuese të kombit shqiptar, i Lidhjes së Prizrenit dhe kryengritjeve të mëdha që sollën Pavarësinë e Shqipërisë. Por, Kosova e lirë dhe e pavarur, është faqja më e ndritur në historinë e kombit, është kryevepra e tij politike më madhështore që nga koha e Skënderbeut, gjer në ditët e sotme.

Prandaj, edhe fjalët e para që burojnë nga zemra dhe shpirti im janë një nderim dhe

mirënjohje e thellë dhe e pakufishme për ju, baballarët dhe gjyshërit tuaj, për qindra dhe mijëra burra dhe gra, martirë të kësaj toke që me sakrificat, qëndresën epike për liri, dinjitet njerëzor dhe kombëtar, që nga viti 1878 gjer në fundin e shekullit që shkoi, fituan pavarësinë, duke bërë që drita e lirisë dhe flakët e saj të mos shuhen kurrë në Kosovë dhe që sot, kombi ynë në tërësi dhe çdo shqiptar në veçanti, të jetë i lirë dhe të fitojë dinjitetin që meriton. Liria është shpirti i vërtetë i një kombi. Njëlloj si shpirti, liria kombëtare është një dhe e pandarë. Sot jemi të lirë, lavdi zotit!

(Duartrokitje)

Sot, dua që nga kjo platformë, një nderim të veçantë të shpreh për burrin e madh të Kosovës dhe të kombit shqiptar, arkitektin e pavarësisë së Kosovës, Presidentin Ibrahim Rugovë, që me përfaqësimin e civilizuar, guximin, urtësinë dhe mençurinë e tij bëri që Kosovën ta donin edhe ata që s'e kishin dashur, ta njihnin edhe ata që nuk e kishin njohur.

Ky burrë vigan i kombit tonë ndërtoi në kushtet e okupacionit të egër në Kosovë pushtetin paralel dhe çështjen e drejtë të shqiptarëve të Kosovës e ngriti nga një barakë e vogël në qendër të Prishtinës, deri në zyrën ovale të Presidentit të Shteteve të Bashkuara dhe kancelaritë e mëdha të Evropës, si dhe udhëhoqi me guxim dhe sukses Kosovën gjer në prag - shpalljen e pavarësisë së saj. Kombi do të nderojë për jetë burrin e tij të madh!

Unë dhe çdo shqiptar përulëm me nderimin më të madh para komandantit legjendar, tribunit të lirisë, Adem Jashari...

(Duartrokitje)

...që me sakrificën e tij të madhe ndezi dritën e lirisë dhe të pavarësisë së Kosovës. Ai dhe të gjithë luftëtarët e lirisë, djemtë dhe vajzat e Kosovës, që luftuan në fundin e viteve '90 dhe fituan luftën e fundit çlirimtare në Evropë, mbrojtën nderin dhe dinjitetin kombëtar dhe njerëzor të çdo shqiptari. Kombi shqiptar do të përulet me nderim të madh gjithnjë para tyre.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Pavarësia e Kosovës shënoi fundin e njëres prej padrejtësive më të mëdha jo vetëm të Ballkanit, por edhe të gjithë Evropës, ndaj dhe pas rënies së Murit të Berlinit, shpallja e pavarësisë së Kosovës është ngjarja më e madhe në historinë e lirisë, jo vetëm të kombit shqiptar dhe të rajonit, por dhe të mbarë Evropës, pas Luftës së Dytë Botërore.

Kosova u bë e lirë dhe e pavarur, sepse udhëheqja dhe qytetarët e Kosovës, me qëndresën, sakrificën dhe luftën e tyre ia dolën të fitojnë mendjen dhe zemrën e qytetarëve, ligjvënësve dhe presidentëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, burrështetasve, qytetarëve dhe qeverive të vendeve të mëdha të lirisë të Evropës, vendeve anëtare të Aleancës së Atlantikut të Veriut, e cila dhjetë vjet më parë, nën udhëheqjen e Presidentit Clinton, ndërmoi betejën e parë në historinë e saj për liritë dhe të drejtat

njerëzore dhe për çlirimin e Kosovës. Shqiptarët në Kosovë, por edhe në Shqipëri dhe kudo që janë, ju mbeten përjetë mirënjohës atyre.

Zoti e bekoftë NATO-n dhe vendet anëtare!

(Duartrokitje)

Zonja deputete dhe zotërinj deputetë,

As edhe një komb tjetër në Evropë nuk ka patur të shkuar më të vështirë, më dramatike dhe të dhimbshme se sa kombi shqiptar. Historia, në të shkuarën madje edhe të afërt të saj, u soll si një njerë e pamëshirshme ndaj nesh. Ajo na rezervoi ne shqiptarëve pushtime të gjata, spastrime çnjerëzore, copëtime të mëdha dhe të dhimbshme, racizma primitive, ksenofobia të egra, diktatura orveliane. Ajo na rrëmbeu toka, territore dhe pasuri, mori qindra e mijëra jetë njerëzish, por më keq akoma na vrau kohën, na grabiti të ardhmen. Mirëpo, ne jo vetëm mbijetuam, por dhe fituam. Arritëm të mbrojmë dhe mbrujmë vokacionin tonë përëndimor, identitetin tonë kombëtar.

Ne, më në fund, hymë në rrugën e ndërtimit të së ardhmes që meritojmë. Është e vërtetë se rruga e mundimeve dhe sakrificave tona ka qenë e pashembullt, por shqiptarët në Shqipëri, Kosovë dhe kudo që jetojnë, kanë njohur dhe po përjetojnë dekadat e fundit, mbështetjen, bujarinë, solidaritetin dhe ndihmën e gjithanshme më të madhe në tërë historinë e tyre nga vendet e lira mike dhe institucionet ndërkombëtare.

Shqiptarët sot janë të përkushtuar, të vendosur që sakrificat, përpjekjet e tyre të jashtëzakonshme për liri dhe dinjitet, ndihmën dhe solidaritetin e madh të miqve të tyre t'i shndërrojnë në energji të pashtershme dhe përkushtim për paqen, stabilitetin, për ndërtimin e të ardhmes së tyre evropiane.

Ne sot, jetojmë në një rajon në të cilin, konfliktet e djeshme janë zëvendësuar, në tërësi, me frymën e bashkëpunimit, mirëkuptimit, përpjekjes për integrimin rajonal, evropian dhe euroatlantik. Shqiptarët, më shumë se të gjithë të tjerët, kanë interesin dhe vullnetin të ndjekin me seriozitetin më të madh këto rrjedha, Ne, vërtet jemi një komb i ndarë në disa shtete, por sot jemi të lire, të bashkuar ne idealin tonë evropian dhe të vendosur që hijet e të shkuarës të mos zbehin dritën e të ardhmes sonë evropiane.

Sot, në bindjen time më të thellë, interesi jetik kombëtar për çdo shqiptar kudo që jeton, është mosndryshimi dhe respektimi i kufijve aktual ndërkombëtar të rajonit të Ballkanit, konsolidimi i pavarësisë së Kosovës nëpërmjet njohjes së mëtejshme ndërkombëtare të saj dhe të ndërtimit të demokracisë së bazuar në vlerat e tregut, integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian, perspektiva e sigurt dhe integrimi Euroatlantik dhe Evropian i Republikës së Kosovës, pra është bashkimi ynë në Evropën e bashkuar. Këto gjykoj se janë dhe interesat më të mëdha, më jetike, më udhëheqëse për ne shqiptarët. Prandaj, edhe për Shqipërinë, për Kosovën, integrimi evropian dhe Euroatlantik janë dhe do të mbeten ylli polar, që ndriçon rrugën e të ardhmes sonë.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Këto 20 muaj kanë qenë kohë historike dhe suksesesh të mëdha për udhëheqjen politike, institucionet dhe për popullin e Kosovës. Në një kohë të shkurtër Republika e Kosovës, një vend i vogël, po shndërrohet në një faktor të rëndësishëm paqe, stabiliteti dhe bashkëpunimi rajonal. Këto 20 muaj janë periudha më stabël që Ballkani ka pasur në 100 vitet e fundit.

Pavarësinë e Kosovës e kanë njohur 62 vende ndër të cilat fuqitë më të mëdha të botës së lirë dhe Evropës, si dhe institucionet prestigjioze ndërkombëtare më të mëdha si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore. Sot Kosova ka miq të mëdhenj e të çmuar, më shumë se kurrë në historinë e saj – Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendeve të mëdha të Evropës, Francën, Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Italinë dhe vende të tjera mike në të katër anët e globit, nga Australia në Japoni, nga Arabia Saudite në Kanada. Dhjetëra vende mike janë angazhuar në shqyrtimin e kërkesës së pavarësisë së Kosovës, si dëshmi e vullnetit të tyre për të kontribuar në paqen dhe stabilitetin në rajonin tonë. Në 20 muaj parlamenti, qeveria, institucionet dhe populli i Kosovës i faktuan dhe po faktojnë përditë botës përkushtimin e tyre të madh për paqe, demokraci dhe për ndërtimin në Kosovë të një shoqërie të lirë ku qytetaret shqiptarë, serbë, malazez, boshnjakë, turq, romë jetojnë në harmoni dhe të barabartë përpara ligjit si dhe integrimin e tyre në NATO dhe Bashkimin Evropian. Qeveria shqiptare është totalisht e angazhuar në promovimin dhe lobimin tek qeveritë e vendeve tjera mike për njohjen e Republikës së Kosovës, si një kontribut real i tyre në paqen dhe stabilitetin në rajonin tonë.

Në një kohë rekord Parlamenti dhe institucionet e Kosovës, forcat politike – Qeveria, kanë ndërmarrë reformat më të thella dhe më të gjithanshme në historinë e vendit, kanë projektuar, miratuar dhe po zbatojnë me sukses Kushtetutën demokratike, ligjet bazë të standardeve më të mira të institucioneve të reja të sistemit demokratik dhe ekonomisë së tregut.

Sot, në Kosovën e pavarur, tensionet ndëretnike janë gjithnjë në rënie dhe më të ulëta se kurrë më parë. Shoqëria plurifetare dhe multietnike e Kosovës po konsolidohet në traditën e shkëlqyer shqiptare të harmonisë dhe bashkëjetesës ndëretnike dhe tolerancës së shkëlqyer fetare. Sot largimet nga Kosova, për motive ndëretnike po zëvendësohen me kthimin e të shpërngulurve në shtëpitë e tyre. Unë kam bindje se ju këtu, në Kosovë, do të shfrytëzoni të gjitha mundësitë dhe po i shfrytëzoni për të konsoliduar standardet më të gjëra, më të larta të drejtave dhe të lirive të pakicave në rajon dhe më gjerë.

Qeveria shqiptare është e vendosur të ndihmojë Qeverinë e Kosovës në përpjekjet e saj për sistemimin e personave të shpërngulur.

Arritjet në luftën kundër kriminalitetit dhe korrupsionit përbëjnë një sukses të rëndësishëm të qeverisë dhe të institucioneve të Kosovës. Ekonomia e juaj është një ekonomi dinamike, e cila po rritet gjithnjë dhe interesi për investimet e huaja vjen e shtohet.

Në Kosovë Aleanca e Atlantikut të Veriut ka vendosur KFOR-in, njësitë e të cilit kanë bërë një punë të shkëlqyer duke dhënë një kontribut historik për paqen, stabilitetin jo vetëm këtu, por në mbarë rajonin tone. NATO ka ndihmuar dhe po ndihmon Kosovën për organizimin dhe reformimin e forcave të sigurisë, si një kusht për progresin e saj drejt anëtarësimit në NATO. Bashkimi Evropian, të gjitha vendet anëtare kanë sjellë këtu një mision të madh EULEX-in për t'ju mbështetur ju në ndërtimin e shtetit ligjor dhe të demokracisë funksionuese, në garantimin dhe respektimin e standardeve më të mira evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut, liritë dhe të drejtat e pakicave. Në një hark të shkurtër kohor, misioni i EULEX-it ka bërë dhe po bën një punë të admirueshme, ka dhënë dhe po jep një kontribut të pazëvendësueshëm në konsolidimin e institucioneve të shtetit demokratik të Kosovës dhe ekonomisë së lirë të tregut, kontribute këto përcaktuese për perspektivën dhe të ardhmen e integritit të Kosovës në Bashkimin Evropian.

Me këtë rast, unë dua t'u shpreh mirënjohjen e thellë KFOR-it dhe EULEX-it, Shteteve të Bashkuara dhe vendeve anëtare të NATO-s, vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe Komisionit Evropian për kontributin e tyre madhor që japin për paqen dhe stabilitetin në Kosovë, që rrezaton pozitivisht në mbarë rajonin tonë.

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Kosovës po zhvillohen dhe intensifikohen çdo ditë në interesin më të mirë të qytetarëve tanë.

Shqipëria dhe Kosova janë dy vende vëllezër. Ato janë dy vende të ndryshme, por jo kurrë të huaja për njëra-tjetrën. Ato me një bashkëpunim të gjithanshëm, partneritet vëllazëror duhet të kapërcejnë pasojat e gjithanshme të ndarjes shekullore, bazuar në proceset dhe standardet më të mira të integritit Evropian. Shqipëria do t'i japë Kosovës të gjithë ndihmën për integrimin e saj në NATO dhe në proceset integruese evropiane.

Unë kam bindje se marrëdhëniet e ngushta midis Shqipërisë dhe Kosovës janë interesi më i mirë i bashkëpunimit rajonal dhe më gjerë. Dy vendet tona, me vepra duhet t'ju provojnë fqinjëve dhe të gjithë vendeve të tjera mike dhe partnere, se dy vende të pavarura në tërësi të banuara nga shqiptaret, janë dhe do të jenë për to dy miq të vërtetë në rajon. Ne nuk duhet të harrojmë për asnjë moment se shqiptaret, si në Shqipëri, ashtu dhe në Kosovë jemi me kohëhumbur më shumë se të gjithë të tjerët në rajon dhe më gjerë. Pra, për ne është jetike dhe vendimtare të kapim orën evropiane, të kapim orën globale. Sigurisht që dhimbjet, vuajtjet, sakrificat ne do t'i nderojmë. Ato nuk harrohen, por në asnjë rast nuk mund të pengojnë apo vështirësojnë bashkëpunimin miqësor me vendet e rajonit dhe vendet e tjera. Historia na ka imunizuar në komplekset. Fobia ndaj shqiptarëve është thjesht një atavizëm që nuk i vlen më askujt. Shqiptarët dhe serbët, jam i bindur se do të gjejnë kurajën, mençurinë për një kapitull të ri në marrëdhëniet midis tyre në interesin më të mirë të vendeve dhe kombeve, por dhe të rajonit në tërësi. Shqipëria është e gatshme të punojë me vendosmëri në këtë drejtim.

Shqipëria dhe Kosova duhet dhe po rindërtojnë infrastrukturën e re moderne. Ne jemi të vendosur që me Kosovën dhe të gjitha vendet përreth të adaptojmë çdo ditë e më shumë standardet e njëjta me ato të vendeve të tjera të Bashkimit Evropian për lëvizjen e mallrave dhe të qytetarëve.

Shqipëria po bën përpjekje të mëdha për të dyfishuar të gjitha lidhjet e transportit dhe lidhjet tjera me Italinë, Greqinë, Maqedoninë, Kosovën dhe Malin e Zi.

Qeveria shqiptare parashikon, gjatë këtyre katër viteve, të dyfishojë këto lidhje infrastrukturore. Pas ndërtimit të korridorit Durrës-Prishtinë, ne parashikojmë ndërtimin e autostradës tjetër Qafë-Morinë - Shkodër, dhënien me koncesion për 99 vjet të Portit të Shën-Gjinit për Republikën e Kosovës, si dhe fillimin e projektimit dhe më pas të ndërtimit të linjës hekurudhore që lidh Shqipërinë me Kosovën. Ne do të kompletojmë lidhjen hekurudhore me Maqedoninë. Së shpejti, me ndihmën bujare të Qeverisë Gjermane, do të fillojmë ndërtimin e linjës së tensionit të lartë 42 KV me Kosovën dhe më pas, një të tillë, do ta ndërtojmë me Maqedoninë.

Ne firmosëm sot me Qeverinë e Kosovës një seri marrëveshesh të rëndësishme të bashkëpunimit për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe të mallrave, luftën e përbashkët kundër kriminalitetit, për arsimin dhe një seri tjera marrëveshesh në fushën ekonomike, të kulturës dhe të turizmit janë në përgatitje e sipër. Marrëdhëniet midis dy vendeve tona vëllezër do t'i shndërrojmë në marrëdhënie model, në interesin më të mirë të qytetarëve të rajonit. Marrëveshje të tjera do të nënshkruajmë edhe me të gjitha vendet.

Unë dua ta mbyll këtë fjalë me një përsëritje vëllazërore për të gjithë qytetarët e Kosovës, për përfaqësuesit e tyre të lartë në këtë parlament, por edhe të shpreh kënaqësinë dhe krenarinë time sepse nuk di ndonjë vend tjetër që ka lindur në kushte të ngjashme me këto të Kosovës, që të ketë arritur rezultate që janë shënuar në këtë vend në më pak se dy vjet pavarësi. The Newborn në 20 muaj paraqitet sot si i ri i pjekur. Unë dua t'i uroj atij rini të përjetshme dhe përjetësi!

Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës!

Zoti e bekoftë Shqipërinë!

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Falënderoj Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, zotin Berisha për fjalën e ngrohtë. Dhe tani ftoj Presidentin e Republikës së Kosovës, zotin Fatmir Sejdiu për t'i dhënë dekoratën Kryeministrit të Shqipërisë, zotit Berisha.

PRESIDENTI I KOSOVËS, FATMIR SEJDIU: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Krasniqi.

I nderuari Kryeministër i Kosovës, Hashim Thaçi,

Të nderuar deputetë dhe ministra të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës,

I nderuari z.Feith dhe Kermabo

Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe të misionëve diplomatike në Kosovë,

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që edhe një herë në emër të qytetarëve dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës, t'ju shpreh mirëseardhjen më të përzemërt Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, zotit Sali Berisha, i cili, padyshim, pati rol historik në ndryshimet dhe të arriturat e mëdha të Shqipërisë dhe të gjithë rajonit tonë gjatë dy dekadave të fundit.

I nderuari Kryeministër Berisha,
Qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës ju falënderojnë nga zemra për përkrahjen e pa rezervë që ju, Qeveria dhe i gjithë populli i Shqipërisë i keni dhënë Kosovës në vazhdimësi në çastet më të rënda të historisë sonë.

Republika e Shqipërisë ka qenë përherë zë i artikuluar i mbështetjes së aspiratave legjitime të popullit të Kosovës për liri, pavarësi dhe demokraci. Shteti shqiptar është edhe sot i përkushtuar tërësisht për ta mbështetur Republikën e Kosovës. Ky përkushtim dëshmohet kudo dhe kurdo që Shqipërisë i jepet rasti të flasë për Kosovën dhe të drejtën e saj absolute për të qenë e lirë dhe e pavarur.

I nderuar Kryeministër Berisha,

Republika e Kosovës deri sot është njohur nga 62 shtete sovranë e demokratike të botës. Ne po punojmë që ky numër të rritet, sepse jemi të vendosur që procesin e pakthyesëm të integritetit euroatlantik të vendit tonë ta përmbyllim me sukses.

Duke ripohuar zotimin tonë për garantimin e plotë të lirisë dhe të të drejtave të secilit qytetar pa dallim etnie dhe besimi, ne ritheksojmë po ashtu se Kosova është dhe do të jetë gjithmonë faktor i paqes, i stabilitetit dhe i së ardhmes prosperuese për tërë rajonin.

Qytetarë të dashur të Republikës së Kosovës,
Zonja dhe zotërinj,

Kryeministri Sali Berisha është dëshmuar si një lider vizionar dhe i vendosur në sfidat e shumta me të cilat është ballafaquar. Ai me sukses punoi për Shqipërinë e integruar në institucionet euroatlantike dhe pati një rol vendimtar në transformimin e madh të Shqipërisë gjatë këtyre dy dekadave të fundit.

Nën udhëheqjen e tij, si president dhe kryeministër, por edhe si lider i opozitës, Shqipëria doli nga izolimi shumëvjeçar dhe iu bashkua botës së lirë e demokratike. Me kënaqësi të jashtëzakonshme sot themi se Republika e Shqipërisë është anëtare e NATO-s, është në rrugë të mirë drejt integritetit në Bashkimin Evropian dhe po shënon çdo ditë rezultate të pamohueshme ekonomike.

Inaugurimi i autostradës Durrës-Morinë është një nga arritjet më të mëdha të Qeverisë Berisha, e cila duke jetësuar “udhën e kombit” – ide e hershme edhe e Presidentit Rugova, krijoi mundësi të reja për bashkëpunimin dhe afrimin në mes dy vendeve tona.

Prandaj, duke i pasur parasysh të gjitha cilësitë e personalitetit dhe meritat e tij si lider politik dhe si burrështetas, dhe duke u mbështetur në kompetencat që m'i jep Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si President i vendit, unë sot e kam dekoruar Kryeministrin Berisha me "Medaljen e Artë të Lirisë".

(Duartrokitje)

Zoti e bekoftë Republikën e Shqipërisë!
Zoti e bekoftë Republikën e Kosovës!
Zoti i bekoftë miqtë tanë!

I nderuar Kryeministër Berisha, duke ju falënderuar edhe një herë juve personalisht, Qeverinë tuaj dhe gjithë popullin e Shqipërisë, ju lus që të vini dhe ta pranoni këtë mirënjohje.

(Duartrokitje)

(Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu, i dorëzon Medaljen e Artë të Lirës Kryeministrit Sali Berisha)

KRYEMINISTRI SALI BERISHA: Zoti President,
Medalja e Artë e Lirisë që Ju ma akordoni sot, përbën për mua një akt madhor krenarie për të gjithë kontributin që qytetarët e Kosovës dhe Kosova dha për lirinë e kombit, për lirinë e rajonit dhe më gjerë.

(Duartrokitje)

Përbën për mua nderimin më të madh sepse këtu në Kosovë u zhvilluan të gjitha lëvizjet e mëdha për liri të shqiptarëve, ndaj edhe unë ndjehem shumë krenar me Medaljen që më dhatë sot.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,
Të nderuar mysafirë,
Zonja dhe zotërinj,
Në emër të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe në emrin tim personal, falënderoj Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, zotin Sali Berisha për fjalën përmbajtësore të adresuar deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me këtë, konstatoj përfundimin e seancës së sotme dhe ju falënderoj për pjesëmarrje.

Përgatiti: **Njësia e Transkripteve.**